



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	maj 2017
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhuruara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit **maj**, në **6** zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **4,351** kërkesa, nga të cilat janë aprovuar **4,241** kërkesa, refuzuar **21** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **147 kërkesa**, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastrale;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licensuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Në Drejtorinë e Kadastrit gjatë muajit maj 2017, nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve të saj janë pranuar kërkesa të ndryshme.

Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 377 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë aprovuar 257, refuzuar 16 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 104 konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- 17 kërkesa për historiate nga persona fizikë, institucione, ku janë aprovuar të gjitha kërkesat;
- 242 shkresa / kërkesa nga institucionet e ndryshme, ku janë realizuar të gjitha.
- 62 kërkesa për përmirësime, nga të cilat janë aprovuar 45, janë refuzuar 4 dhe 13 janë në procedurë;
- 1 kërkesë për regjistrim të barrës tatimore dhe 1 për lirim nga barra tatimore, të aprovuara;
- 86 kërkesa për regjistrim të hipotekave, të gjitha të aprovuara dhe 48 kërkesa për çregjistrim, nga të cilat janë aprovuar 47 dhe 1 ka ngelur në procedurë.

Totali i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë 1,050, nga të cilat 912 kërkesa janë aprovuar, 20 janë refuzuar dhe 118 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 1,891 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe 1,144 kërkesa për kopje të planit, ku gjithsej janë pranuar dhe realizuar 3,035 kërkesa;
- 27 kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë aprovuar 19 dhe 10 janë në procedurë, nga të cilat 2 janë nga muaji i kaluar;
- 7 kërkesa për incizim të ndërtesave, nga të cilat 6 janë aprovuar dhe 1 ka ngelur në procedurë;
- 15 kërkesa për bashkim të parcelave, nga të cilat janë aprovuar 19 dhe 3 kanë mbetur në procedurë, nga të cilat 7 janë nga muaji i kaluar;
- 54 kërkesa për dhënie e produktëve (koordinatave) - të realizuara të gjitha;
- 73 kërkesa për identifikimin e njërive banesore, nga të cilat janë aprovuar 83 dhe 8 kanë mbetur në procedurë, nga të cilat 18 janë nga muaji i kaluar;
- 10 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë aprovuar 14 dhe në procedurë është 1, ndërsa 5 kërkesa janë nga muaji i kaluar;
- 1 kërkesë për ndërrim kulture e cila është aprovuar;
- 63 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë aprovuar 82 dhe 6 kanë mbetur në procedurë për shqyrtim;
- 15 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizmit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., nga të cilat janë aprovuar të gjitha.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë 3,301, nga të cilat 3,329 kërkesa janë aprovuar, 1 është refuzuar dhe 29 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka realizuar rreth **90** për qind (%) të planit të saj, duke i aprovuar, refuzuar dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Aktivitetet në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Aktivitetet në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësisive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. **STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.**

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, maj 2017	Numri total i kërkesave	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	3,035	3,035	0	0	14,330
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	377	257	16	104	14,060
Kërkesa për historik zyrtarë, historik për persona fizikë dhe juridikë	17	17	0	0	210
Kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	242	242	0	0	13
Përmirësime në RDPP	62	45	4	13	1,240
Lirim nga barra tatimore	1	1	0	0	10
Barra tatimore	1	1	0	0	30
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	86	86	0	0	9,660
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	48	47	0	1	480
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësim lënde etj.	216	216	0	0	130
Ndarjet - parcelizimet	27	19	0	10	2,660
Incizimi i ndërtesave, banesave	7	6	0	1	3,100
Bashkimi i parcelave	15	19	0	3	1,060
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	54	54	0	0	2,434
Identifikimi i parcelave dhe njësisve banesore	73	83	0	8	1,480
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	10	14	0	1	460
Ndërrim i kulturës	1	1	0	0	898
Plotësim pagese - gjeodezi	1	1	0	0	75
Kërkesat me licencë	63	82	0	6	8,525
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	15	15	1	0	42

Totali	4,351	4,241	21	147	60,897
---------------	--------------	--------------	-----------	------------	---------------

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3 Takimet me palë

- **Spektori i kadastrit**, gjegjësisht zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (*të martave dhe të enjteve*) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth 415 qytetarë.
- **Spektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë, ku gjatë muajit maj ka pranuar 335 palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. Takimet me institucione të tjera

- **Spektori i kadastrit** ka pasur takime me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale - pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'i drejtohen institucioneve tjera në vend. Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyera nga kjo agjenci.

5.1.1 Diskutime Publike/Takimet me qytetarë - Nuk kemi pasur.

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

6.1.1 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

- Spektori i kadastrit:

- Lëndë të pranuar: 1,050
- Lëndë të aprovuara: 912
- Lëndë të refuzuara: 20
- Lëndë në procedurë: 118

- Spektori i gjeodezisë:

- Lëndë të pranuar: 3,301
- Lëndë të aprovuara: 3,329
- Lëndë të refuzuara: 1
- Lëndë në procedurë: 29

7. **Takime të tjera - nuk ka.**

8. **SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Spektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucionet, moskthimi i përgjigjeve nga ana e tyre në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- 7 kërkesa presin për verifikime ne Arkiv Komunal dhe Nderkomunal;
- 173 kërkesa presin për verifikime ne Gjykate;
- 12 kërkesa presin për verifikime në privatizim;
- 10 kërkesa presin për verifikime ne NPB;
- 38 kërkesa presin për verifikime në KPA;
- 3 kërkesa presin për verifikime në Drejtorinë e Financave dhe Pronës.

Spektori i gjeodezisë:

- Sfidues mbetet komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, moskthimi i përgjigjeve nga ana e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin “CadastralMap” dhe “SITK”, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

9. **REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.**

Spektori i kadastrit:

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

Spektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punëtorë sa i përket aplikimit të Kornizës së punës.

10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues*

Spektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Spektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisve banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licensuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

11. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.*